



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Raport përfundimtar për të hyrat e lejuara maksimale të OSSH-së Përgjigje ndaj Komenteve Periudha e Tretë Rregulative (2023 – 2027)

DEKLARATË

Ky Dokument është përgatitur me qëllim të informimit të palëve të interesit gjatë procesit të konsultimit publik. Dokumenti duhet të lexohet krahas Raportit Konsultativ të ZRRE-së të publikuar më 16 shkurt 2023. Dokumenti nuk paraqet Vendim të ZRRE-së dhe nuk duhet të konsiderohet si i tillë.

23 mars 2023

Përmbajtja

Tabela e shkurtesave	4
1. Hyrje	5
2. Komentet nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)	6
2.1 Ndryshimi i çmimit të energjisë për mbulimin e humbjeve në transmetim	6
2.1.1 Komentet e KEK	6
2.1.2 Përgjigjja e ZRRE-së	6
3. Komentet nga Sindikata e pavarur Elektrokosova KEDS/KESCO	7
3.1 Ngritja e pagave për punonjësit e kompanisë KEDS/KESCO	7
3.1.1 Komentet e Sindikatës së pavarur Elektrokosova KEDS/KESCO	7
3.1.2 Përgjigjja e ZRRE-së	7
4. Komentet nga Qeveria e Republikës së Kosovës	8
4.1 Ndarja e subvencioneve	8
4.1.1 Komentet e Qeverisë së Republikës së Kosovës	8
4.1.2 Përgjigjja e ZRRE-së	8
4.2 Caku i i humbjeve për OSSh	8
4.2.1 Komentet e Qeverisë së Republikës së Kosovës	8
4.2.2 Përgjigjja e ZRRE-së	8
5. Komentet nga OSSH - KEDS	9
5.1 Përshtatjet për investimet kapitale në PRR2	9
5.1.1 Komentet e KEDS	9
5.1.2 Përgjigjja e ZRRE-së	9
5.2 Plani investiv për periudhën e ardhshme rregullative (PRR3)	10
5.2.1 Komentet e KEDS	10
5.2.2 Përgjigjja e ZRRE-së	10
5.3 Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes (OPEX)	11
5.3.1 Komentet e KEDS	11
5.3.2 Përgjigjja e ZRRE-së	12
5.4 Kostot e humbjeve të energjisë	12
5.4.1 Komentet e KEDS	12
5.4.2 Përgjigjja e ZRRE-së	13
5.5 Të hyrat e parregulluara dhe kostot e përjashtuara	13

5.5.1	Komentet e KEDS	13
5.5.2	Përgjigjja e ZRRE-së	13
5.5.3	Përshtatjet e rregullta vjetore 2023	13
5.5.4	Komentet e KEDS	13
5.5.5	Përgjigjja e ZRRE-së	13
6.	Përmbledhje e MAR të OSSH (KEDS)	15

Tabela e shkurtesave

Shkurtesat e përdorura në këtë dokument kanë këtë kuptim:

CPI	Consumer Price Index
EEX	European Energy Exchange
EUROSTAT	European Statistical Office
FSHU	Furnizuesi i Shërbimit Universal
HLM/MAR	Të Hyrat e Lejuara Maksimale
KEDS	Kompania Kosovare e Shpërndarjes dhe Furnizimit të Energjisë Elektrike
KEK	Korporate Energjetike e Kosovës
KESCO	Kompania Kosovare e Furnizimit me Energji Elektrike
KESH	Korporata Elektroenergjetike Shqiptare
KOSTT	Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut i Kosovës
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MWh	Megavat orë
OPEX	Operational Expenditure- Shpenzimet Operative
OSSH	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes
OST/OT	Operatori i Sistemit, Transmisionit , Operatori i Tregut
PRR 3	Periudha e Tretë Rregullative
ZPRK	Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovë
ZRRE	Zyra e Rregullatorit për Energji

1. Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është në procesin e Shqyrtimit Periodik për Periudhën e Tretë Rregullative (PRR 3), e cila përfshinë përcaktimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale (HLM) për periudhën 2023-2027. Shqyrtimi Periodik do të përcaktojë të Hyrat e Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit, të Transmisionit dhe Tregut (OST/OT-KOSTT sh.a) dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH-KEDS sh.a).

Pas vlerësimit fillestar të Aplikacioneve lidhur me të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM/MAR) për të licencuarin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH-KEDS sh.a), i licencuari dhe palët tjera të interesit kanë pasur mundësi t'i paraqesin komentet e tyre përmes konsultimit publik për periudhë dy javore.

Ky dokument paraqet përgjigjet në komentet e bëra nga palët e interesuara, dhe propozimin e ZRRE-së lidhur me të Hyrat e Lejuara Maksimale të OSSH-së.

Lidhur me vlerësimin fillestar të të Hyrave të Lejuara Maksimale të OSSH-së, ZRRE ka pranuar komente nga:

- Korporata Energjetike e Kosovës (KEK),
- Sindikata e pavarur Elektrokosova KEDS/KESCO,
- Qeveria e Kosovës, dhe
- OSSH – KEDS

Komentet e pranuar nga palët e interesit janë publikuar në faqen elektronike të ZRRE-së. Në këtë pjesë të Dokumentit japim një përmbledhje e këtyre komenteve si dhe përgjigjet e ZRRE-së mbi to.

2. Komentet nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)

2.1 Ndryshimi i çmimit të energjisë për mbulimin e humbjeve në transmetim

2.1.1 Komentet e KEK

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) thekson se marrëveshja aktuale për çmime me palët KEDS, KESCO dhe KOSTT skadon me datën 31.03.2023. Për shkak të ndryshimeve në kostot e eksploatimit të thëngjillit, prodhimit të energjisë elektrike nga Termocentralet si dhe nga rritja e tarifave të KOSTT, KEK kërkon nga palët që të marrin parasysh çmimet e rishikuara nga KEK për periudhën 01.04.2023 – 31.03.2024 siç vijojnë:

- Çmimi i energjisë elektrike për mbulimin e Furnizimit për Shërbim Universal – 32.40 €/MWh;
- Çmimi i energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në shpërndarje – 39.54 €/MWh;
- Çmimi i energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në transmetim – 39.54 €/MWh;

2.1.2 Përgjigjja e ZRRE-së

Duhet të theksohet se me ndryshimet ligjore që rregullojnë sektorin e energjisë të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në vitin 2016, ZRRE ka amandamentuar legjislacion sekondar për të qenë në harmoni me legjislacionin primar, prandaj në këtë kuptim çmimet e prodhimit për gjeneratorin publik KEK nuk rregullohen nga ZRRE që nga viti 2017, por ato i nënshtrohen kushteve të tregut. Çmimi për të cilin palët tregtare mund të arrijnë pajtimin ndërmjet tyre duhet të jetë në pajtim me Procedurën për Tregtimin e Energjisë, Rregullat e Tregut dhe kërkesat tjera të legjislacionit sekondar.

ZRRE deri me tani nuk ka pranuar ndonjë kërkesë ndryshe nga palët të Hyrat e Lejuara Maksimale të të cilave i nënshtrohen rregullimit. Prandaj, në vlerësimin e kostove me shumicë për vitin 2023, ZRRE ka marrë në konsideratë propozimet e palëve që bazohen në çmimet aktuale. Sidoqoftë, palët duhet të respektojnë parimet e sipërpërmendura në azhurnimet e çmimeve me shumicë në të ardhmen.

3. Komentet nga Sindikata e pavarur Elektrokosova KEDS/KESCO

3.1 Ngritja e pagave për punonjësit e kompanisë KEDS/KESCO

3.1.1 Komentet e Sindikatës së pavarur Elektrokosova KEDS/KESCO

Sindikata e pavarur Elektrokosova KEDS/KESCO kërkon nga ZRRE që të merr parasysht ngritjen e pagave për punonjësit e kompanisë KEDS/KESCO, në vlerën e OPEX për OSSH dhe FSHU. Sindikata e pavarur Elektrokosova KEDS/KESCO i bazon këto kërkesa në:

- Rritjen e çmimeve të produkteve bazë
- Rritjen e inflacionit
- Rritjen e volumit të punës
- Iqjen e numrit të madh të punëtorëve profesional

3.1.2 Përgjigjja e ZRRE-së

Sipas rregullës për të hyrat e lejuara maksimale, ZRRE ka rishikuar kostot e OPEX (ku përfshihen edhe kostot e personelit) duke reflektuar normën vjetore të inflacionit. Norma e inflacionit merr parasysht Indeks të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit të publikuar nga Eurostat. Vlera e publikuar në janar të vitit 2023 për vitin 2022 është 8.4%.¹

Vlen të theksohet se me qëllim që kostot e personelit të KEDS dhe KESCO të jenë të krahasueshme me kostot e personelit të të licencuarve të tjerë në sektorin e energjisë, ZRRE në kuadër të shqyrtimit periodik për periudhën rregullative 2018- 2022 ka azhurnuar kostot e personelit për KESCO në vlerë prej 251 mijë euro, dhe për KEDS dhe KESCO në total në vlerë prej rreth 2.3 milion euro. Këto kosto janë pjesë përbërëse e OPEX-it në PRR3.

Tutje duhet sqaruar për Sindikatën, se ZRRE në pajtim me kornizën ligjore ka azhurnuar dhe do të azhurnojë kostot e OPEX (përfshirë kostot e personelit) për të pasqyruar inflacionin. Prandaj, çështjet e ngritura nga sindikata duhet adresuar në KEDS dhe KESCO.

¹ https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/PRC_HICP_AIND__custom_4860030/default/table?lang=en

4. Komentet nga Qeveria e Republikës së Kosovës

4.1 Ndarja e subvencioneve

4.1.1 Komentet e Qeverisë së Republikës së Kosovës

Nga raporti vërehet se është marrë parasysh edhe ndarja e 24.6 milionë eurove për subvencionim të tarifave nga ana e Qeverisë, mirëpo nuk është e qartë nëse janë marrë parasysh edhe Vendimet 01/117 dhe 02/117 të Qeverisë për mbështetjen e sektorit të energjisë elektrike me ndarjen edhe të 20 milionë eurove tjera shtesë dhe masa në të cilën janë shpenzuar dhe parashihen të shpenzohen gjatë javëve në vijim.

4.1.2 Përgjigjja e ZRRE-së

E adresuar në raportin për përcaktimin e të hyrave për Furnizuesit me Shërbim Universal. Po ashtu edhe komenti për “Mbulimi i hendekut për HLM për 2023 të bëhet kryesisht nga bizneset” është adresuar tek raporti i FSHU-së.

4.2 Caku i i humbjeve për OSSh

4.2.1 Komentet e Qeverisë së Republikës së Kosovës

Për vitin e ri tarifor, caku i humbjeve të lejuara ka mbetur i pandryshuar për vitin 2023, ndërsa ndryshon vetëm 0.4 pikë përqindjeje për vitin 2024, kjo përkundër faktit që OSSh ka për detyrim zvogëlimin e humbjeve, dhe për këtë i njihen edhe investime të lejuara në vlerë prej 28.6 milionë euro për vitin 2023 dhe 37.7 milionë euro për vitin 2024. Me fjalë tjera, konsumatori detyrohet të paguajë për investimet e reja në rrjet, mirëpo nuk i mundësohet të përfitojë asgjë nga reduktimet e humbjeve që rezultojnë nga ato investime. Ju si rregullator do duhej të siguroheshit që të mos krijohen këso raporte asimetrike në mes të palëve, ku konsumatori paguan dy herë – edhe investimet, edhe humbjet e lejuara. Gjithashtu, nuk kishte sqarime të mjaftueshme se çka nënkuptoni me faktorin për ndarjen e humbjeve 50/50 për vitin 2023.

Heqja e konsumit të pjesës veriore të vendit nga përlogaritja e humbjeve të lejuara për OSSh: Këtë çështje e kanë ngritur edhe në komentet e kaluara MFPT. Kjo e fryn nivelin e kostos së humbjeve të lejuara për rreth 57 GWh apo rreth 4.9 milionë euro në vlerë monetare

4.2.2 Përgjigjja e ZRRE-së

ZRRE-ja më 13 shtator 2022 ka publikuar Raportin Konsultativ me propozimet e saj për Humbjet e Lejuara për Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (OST/OT-KOSTT) dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSh/KEDS) për periudhën e tretë rregullative 2023-2027. Në komentet e pranuar nga Ministria e Ekonomisë, konfirmohet pranueshmeria e caktimit dhe lakores së reduktimit të humbjeve në OSSh dhe OST. Komentet e palëve dhe përgjigjet e ZRRE-së janë të publikuara në faqen elektronike të ZRRE-së.²

²https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/Raport%20perfundimtar_ pergjigje%20ndaj%20komenteve_%20per%20humbje.pdf

Procesi i konsultimit publik ka rezultuar me vendimin **V_1636_2022** (16 nëntor 2022)³ mbi “Cakun e reduktimit të humbjeve dhe lakoren e humbjeve të lejuara për Periudhën e Tretë Rregullative (PRR3) 2023-2027 për Rrjetin e Transmetimit (OST) dhe Rrjetin e Shpërndarjes (OSSH)”.

Sidoqoftë, edhe pse ZRRE ka sqaruar qasjen e aplikuar në kalkulimin e nivelit të humbjeve të lejuara për Ministrinë e Financave edhe gjatë procesit të shqyrtimit të jashtëzakonshëm në vitin 2022⁴, ZRRE rithekson se pasi që Operatori i Sistemit të Shpërndarjes nuk ka kontroll në shpërndarjen e energjisë elektrike në katër komunitat veriore, të sqaruar edhe në vendimet PRR2 dhe PRR3, se caku për reduktimin e humbjeve dhe lakores së humbjeve të lejuara aplikohet vetëm për pjesën e Republikës së Kosovës në të cilën operatorët e licencuar kanë kontroll. Megjithatë kurdo që OSSH-ja do të ketë kontroll në katër komunitat e veriut të Republikës së Kosovës, atëherë caku i humbjeve do të aplikohet sipas metodës që përfshinë rrjedhat e energjisë së veriut. Sidoqoftë, pavarësisht prej trajtimit të energjisë që hynë në sistemin e shpërndarjes, pas aplikimit të cilitdo cak për humbje, volumi i humbjeve rezulton i njëjtë.

5. Komentet nga OSSH - KEDS

5.1 Përshtatjet për investimet kapitale në PRR2

5.1.1 Komentet e KEDS

Pavarësisht sfidave OSSH thekson se ka arritur të investojë 107.28 milion euro për periudhën 2018-2022, nga 131 milion € sa kishte aprovuar rregullatori për të njëjtën periudhë. ZRRE në raportin konsultativ të publikuar më 16 shkurt 2023, ka zvogëluar investimet e realizuara në vlerën prej 29.7 milion euro me arsyetimin se janë investime të cilat nuk janë aprovuar nga ZRRE. Për më tepër, për të njëjtat ZRRE-ja ka bërë përshtatjen e zhvlerësimit të lejuar dhe kthimit të lejuar duke aplikuar normën e përbërë të interesit dhe inflacionit, koncept i cili nuk mund të aplikohet në investimet reale. Sidoqoftë, ZRRE i ka cilësuar këto projekte si investime të domosdoshme dhe të njëjtat i bart në 4 vitet e fundit të periudhës së tretë rregullative, megjithëse të njëjtat janë energjizuar dhe konsumatorët janë duke përfituar nga këto investime. Prandaj, duke ditur rëndësinë dhe domosdoshmërinë e tyre për sistemin e shpërndarjes, këto investime duhet të njihen. Duke e shtyrë njohjen për periudhën e ardhshme rregullatore, OSSH-së i lihet të përballojë kostot e investimeve pa të hyra përkatëse, duke e vënë në rrezik funksionimin e përditshëm të OSSH. Marrë parasysh argumentet e lartpërmendura dhe parimet ekonomike dhe financiare, OSSH kërkon nga ZRRE që këto investime të njihen ashtu siç janë realizuar në periudhën e realizimit të tyre.

5.1.2 Përgjigjja e ZRRE-së

Gjatë llogaritjes së përshtatjeve për investimet kapitale të realizuara në krahasim me ato të aprovuara në PRR2, ZRRE ka zbatuar dispozitat e Rregullës për të Hyrat e OSSH-së, sipas së cilave rregullatori do të marrë në konsideratë nëse do ta aprovojë ose jo zëvendësimin e projekteve në shqyrtimin periodik pasues por nuk është i obliguar ta bëjë këtë. Duke u bazuar në arsyeshmëritë e OSSH-së se projektet

³ https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Vendimet/Vendimet%202022/V_1636_2022.pdf

⁴ https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/Raporti%20p%C3%ABrfundimtar%20p%C3%ABr%20MAR_P%C3%ABrgjigje%20ndaj%20Komenteve.pdf

alternative do të sjellin përfitime të njëjta apo më të mira për konsumatorët se projekti fillestar (duke marrë parasysh rezultatet e pritura dhe kostot), ZRRE ka bartur kostot e këtyre projekteve në periudhën 2023-2027.

5.2 Plani investiv për periudhën e ardhshme rregullative (PRR3)

5.2.1 Komentet e KEDS

OSSH në planin pesëvjeçar investues për periudhën rregullative 2023-2027 ka propozuar projekte kapitale në vlerë prej 167mil€, të cilat janë bërë bazuar në analiza teknike dhe me qëllim të arritjes së cakut të humbjeve të përcaktuar nga ZRRE. ZRRE-ja me vendimin numër V_1636_2022 ka aprovuar cakun e lejuar të humbjeve për periudhën e tretë rregullative. Është paradoksale që pas vendimit për cakun e humbjeve ZRRE ka zvogëluar investimet në mënyrë të njëanshme, duke ia pamundësuar OSSH-së arritjet e objektivave të humbjeve të përcaktuara për periudhën e tretë rregullative. ZRRE në raportin konsultativ ka vlerësuar projektet kapitale për periudhën e ardhshme rregullative në vlerë prej 122.1mil€, duke zvogëluar projektet e fokusuar në tensionon e ultë dhe njehsorët elektrik, të ndërlidhura drejtpërsëdrejti me cakun e humbjeve. Në investimet e periudhës së tretë rregullative, siç u argumentua edhe më lartë, ZRRE ka përfshirë edhe projektet e realizuara në periudhën e dytë rregullative në vlerë prej 29.7mil€. Rrjedhimisht, vlera përfundimtare e investimeve për periudhën e tretë rregullative është 151.7 mil€ .

Është e rëndësishme të theksohet se vlerësimet e ZRRE-së për planin investimeve 2023-2027 nuk janë në përputhje me analizat teknike dhe nevojat e rrjetit, me një theks të veçantë për 2 vitet e fundit, mandej të njëjtat nuk janë në harmoni as me Marrëveshjen e Implementimit të datës 17 tetor 2012, nënshkruar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, Investitorë, KEK sh.a. dhe KEDS sh.a.

5.2.2 Përgjigjja e ZRRE-së

ZRRE në vlerësimin e projekteve kapitale për PRR3 ka pasur konsulta dhe komunikime të vazhdueshme me OSSH-në në mënyrë që të adresohen sa më drejtë nevojat e konsumatorëve. Në këtë kuptim, projektet kapitale të planifikuara janë renditur bazuar sipas prioritizimit të tyre.

Plani komisionimit të projekteve kapitale 2023-2027 është bërë duke u bazuar në klasifikimin dhe kategorizimin e projekteve nëpër kategori të aseteve të bazuar në kostot që kanë rezultuar sipas lejimit të ZRRE-së, ashtu që vlera nëpër kategori të caktuara të aseteve dhe nëpër vite të jetë e saktë. Vlerës së kostove për kategori përkatëse të aseteve më pastaj i janë shtuar projektet e bartura nga PRR2 në PRR3, të cilat janë komisionuar në PRR 3 sipas dinamikës së PRR 2.

Për projektet kapitale për të cilat ZRRE nuk pasur informata, vlerësimi është bërë bazuar në të dhënat që OSSH ka ofruar. Projektet e tilla janë projektet që kanë të bëjnë me kalimin 10-20kV, ku nga 47.9mil€ të kërkuara nga OSSH, ZRRE ka njohur kostot në vlerë prej 45.9mil€. Gjithsesi, ZRRE nuk ka hequr projektet e kërkuara, por vetëm në vlerësimin e kostove për njësi ka hequr astetet/transformatorët për të cilët OSSH nuk ka pasur informata.

Dallimet e theksuara ndërmjet projekteve të kërkuara nga OSSH dhe të njohura nga ZRRE kanë të bëjnë me projektet njehsorëve, investimet në tensionin e ultë në vitet 2026-2027 dhe lidhjet e reja. Lidhur me njehsorët, ZRRE vlerësimin e saj e ka bazuar në dinamikën e investimeve të realizuara në PRR 1 dhe PRR 2, numrin e njehsorëve të instaluar në këto dy periudha, numrin e njehsorëve mekanik

aktual, etj. Megjithatë pas konsultimeve me OSSH, për vitin 2023 kostot e njehsorëve janë rishikuar nga 3 në 4 mil€. Sidoqoftë, për vitet në vijim ZRRE ka kërkuar nga OSSh të përpilojë studim të detajuar fizibiliteti duke u bazuar në rezultatet e vitit 2023 për të evidentuar nevojat e investimeve në të ardhmen që kanë të bëjnë me njehsorë.

Për kategorinë e projekteve në TU, ZRRE bazuar në numrin e madh të projekteve të bartura nga PRR2, proceset administrative që kanë të bëjnë me tenderim, realizimet në të periudhat paraprake, nuk sugjeron se OSSH mund të ketë dinamikën e implementimit të projekteve në PRR3 dukshëm të ndryshme se ajo në PRR 1 dhe PRR 2.

Për kostot e projekteve që kanë të bëjnë me lidhjet e reja, ZRRE ashtu siç ka sqaruar edhe më parë, ato nuk duhet të përfshihen në tarifa, ngase për këtë qëllim janë rishikuar Parimet për Përcaktimin e Tarifave për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes, ndërsa dokumenti Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Shpërndarjes duhet të jetë në harmoni me ato. Derisa, kostot për lidhjet e reja e për të cilat OSSh mund të ketë shkaktuar ato do të trajtohen nga ZRRE.

Lidhur me përcaktimin e cakt të humbjeve për PRR 3, ZRRE ka analizuar disa aspekte përveç nivelit të investimeve të planifikuara, prandaj ZRRE sqaron se në përcaktimin e cakt të humbjeve përveç planeve investive ka marrë parasysh edhe disa këndvështrime tjera në përcaktimin e cakt dhe lakores së reduktimit të humbjeve në PRR 3. ZRRE rithekson se përcaktimi i cakt të humbjeve bazohet në politikat e kaluara rregullative, planet investive, analiza teknike, të dhënat historike dhe të parashikuara, si dhe praktikat rregullatore.

Ashtu siç ka sqaruar ZRRE në takimet konsultative, OSSH mund të aplikojë në çdo kohë te rregullatori për të zëvendësuar një projekt kapital në planin e aprovuar të investimit apo të kërkojë përfshirjen e ndonjë projekti të ri, duke respektuar obligimet ligjore të parapara në Rregullën për të Hyrat e OSSh dhe Rregullën për vlerësimin e projekteve kapitale.

Vlen të theksohet se përveç faktorëve të sipërpërmendur, ZRRE ka kërkuar nga OSSh informata për burimet e financimit të këtyre projekteve. Nga informatat e pranuar, OSSH nuk ka ndonjë marrëveshje kredie për financimin e projekteve të planifikuara në PRR3. Ky fakt, si dhe borxhet e mbetura të OSSH-së, nuk rekomandojnë që OSSh të ndër marr investimeve të përshkallëzuara në PRR 3 në krahasim me ato të PRR1 dhe PRR2.

5.3 Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes (OPEX)

5.3.1 Komentet e KEDS

Meqenëse trendi i rritjes së çmimeve është duke vazhduar dhe të njëjtat janë jashtë kontrollit të OSSH, mos-njohja e këtyre kostove sidomos rritja e kostove të materialeve, si dhe aplikimi i faktorit të efikasitetit në këtë linjë, është e paarsyeshme. Prandaj, është i domosdoshëm rishikimi i kostove. Ligji Nr.06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme i miratuar në vitin 2018, parasheh që në vitin e 5 tatimor (2023) të mos ketë zbritje të përgjithshme për tatimin e pronave, në dallim nga vitet e kaluara kur është aplikuar zbritja e përcaktuar sipas këtij ligji. Në këtë kuptim meqë kostot nga tatimi në pronë janë kosto jashtë kontrollit të OSSH kërkojmë nga ZRRE të reflektoj këto kosto gjatë vendosjes për kostot e OPEX për periudhën e ardhshme rregullative. Gjithashtu edhe çmimet për sigurim të aseteve dhe palëve të treta janë rritur për 24.45 % dhe marrë parasysh se të njëjtat janë jashtë kontrollit të OSSH-së, të njëjtat duhen të reflektohen në OPEX-in përfundimtar. Në propozimin për të hyrat e

lejuara maksimale për periudhën 2023-2027, OSSH gjithashtu ka kërkuar nga ZRRE që të vlerësoj çështjen e ngritjes së pagave për punonjësit e kompanisë, e cila nuk është e harmonizuar me pagat e operatoreve të tjerë të sektorit të energjisë në Kosovë. Duke i lejuar Operatorit të Shpërndarjes t'i njihen kostot e rritura në OPEX-in e saj të lejuar, do të ndihmojë operatorin të jetë në gjendje të mbajë një fuqi punëtore kompetente dhe të kualifikuar, e cila është thelbësore për aftësinë e saj për të ofruar shërbim të besueshëm dhe efikas.

5.3.2 Përgjigjja e ZRRE-së

Norma e inflacionit CPI - Për të bërë kalkulimin e përshtatjeve lidhur me normën e inflacionit si referencë është marrë norma e inflacionit e publikuar nga Eurostat për vendet e Eurozonës, e cila për vitin 2022 ishte 8.4%. Norma e cila aplikohet për përshtatjet për inflacion është norma referente e Eurozonës si normë më e arsyeshme dhe e qëndrueshme, ngase kostot përgjithshme kapitale, importi, i nënshtrohen tregut të jashtëm. Në shtojcën 1 të Rregullës e të Hyrave të OSSH-së, theksohet: CPI-t-1 paraqet: *“vlerën aktuale të inflacionit në vitin relevant t-1, të matur duke përdorur “Indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumatorëve (HICP-të) – të gjitha njësitë, për Eurozonën” të publikuara nga Eurostat-i, apo ndonjë masë tjetër e inflacionit që rregullatori e përcakton të jetë si masa më e mirë e ndryshimit për kostot operative dhe të mirëmbajtjes përgjatë kohës dhe që lejohet gjatë shqyrtimit periodik”*.

Mbi këtë parim janë përshtatur edhe kostot e pa-kontrollueshme, përkatësisht kostot e sigurimit të aseteve. Për më tepër duke qenë se kostot e tilla trajtohen si të pa-kontrollueshme, ZRRE ndaj tyre nuk aplikon faktorin e efikasitetit. ZRRE në këtë proces nuk ka pasur ndonjë dëshmi shtesë nga KEDS lidhur me kostot shtesë për kostot e sigurimeve, prandaj ka marrë si pikë fillestare kostot e vitit 2022 të azhurnuara për normën e inflacionit (HICP). Sidoqoftë, ngjashëm si në të kaluarën ZRRE, do ti trajtojë kostot e tilla bazuar në dëshmitë/ofertat e pranuar nga KEDS për kontraktimin e shërbimeve të tilla.

Kosto që kanë të bëjnë me tatimin në pronë do të përshtaten në procesin e rregullte tarifor bazuar në informatat dhe dëshmitë që duhet të ofrohen nga OSSH.

5.4 Kostot e humbjeve të energjisë

5.4.1 Komentet e KEDS

Në propozimin e ZRRE-së për kostot e humbjeve për vitin 2023 ka parashikuar energjinë në hyrje 6,220 GWh ndërsa çmimin e blerjes në 86 €/MWh. Lidhur me energjinë në hyrje të shpërndarjes (EED) ZRRE ka përdorur të njëjtën metodologji sikurse viteve të kaluara duke konsideruar vetëm nivelin e lejuar të humbjeve në nivelin e shpërndarjes. Në parashikimin e blerjeve të energjisë, sikurse ZRRE-ja, ka marrë parasysh shkëmbimet KEK-KESH dhe vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.01/117 dhe 02/117 të datës 29.12.2022. Megjithatë në aplikimin e tij OSSH ka paraqitur edhe kostot për kapacitet për energjinë nga KESH, të cilat kosto janë të domosdoshme për shfrytëzimin e plotë të kësaj energjie, në të kundërtën mos-njohja e kostove të kapacitet rrezikon sjelljen e energjisë nga KESH, duke rrezikuar që kjo energji tutje të mbulohet përmes importit ditor (intraday) e cila ka kosto më të lartë dhe të panjohur në tarifa në vitin relevant.

5.4.2 Përgjigjja e ZRRE-së

ZRRE ka rishikuar kostot për blerje të humbjeve bazuar në të dhënat aktuale për muajt janar dhe shkurt të vitit 2023, si dhe ka azhurnuar parashikimet e çmimeve të importit sipas të dhënave të datës 15 mars 2023 sipas EEX. Po ashtu ZRRE ka pranuar edhe kostot e alokimit të kapaciteteve për energjinë e shfrytëzuar nga OSSh në muajt janar –shkurt 2023. Kostot e humbjeve do të përshtaten gjatë çdo viti rregullativ për të reflektuar: ndryshimin në mes të vëllimeve të parashikuara dhe të realizuara të energjisë, ndryshimin në mes të çmimit të parashikuar dhe të realizuar të energjisë dhe ndryshimin në mes të nivelit të lejuar dhe të realizuar të humbjeve. Kostot e tilla janë të pa-kontrollueshme, si rezultat, ZRRE aplikon përshtatjet mekanike të këtyre kostove.

5.5 Të hyrat e parregulluara dhe kostot e përjashtuara

5.5.1 Komentet e KEDS

ZRRE në MAR-in e propozuar për periudhën e tretë rregullative ka zbritur kostot e përjashtuara në vlerë prej 0.4 mil€, duke mos ofruar argumente lidhur me zbritjen e tyre. Marrë parasysh se ZRRE-ja ka zbritur të hyrat e parregulluara në vlerë prej 5 milion euro, të cilat përfshijnë të hyrat nga shërbimet e përcaktuara në shtojcën 5 të rregullës, zbritja e kostove të përjashtuara që ndërliidhen me dhënien e këtij shërbimi është e paarsyeshme. Si rezultat, të njëjtat nuk duhen të zbriten nga të hyrat e lejuara maksimale.

5.5.2 Përgjigjja e ZRRE-së

Vlerësimi i të hyrave të parregulluara është bazuar në të dhënat e shqyrtimit të kaluara periodik, ndërsa kostot e përjashtuara si vlerë referente kanë marrë për bazë lejimin nga PRR 2, kur pritej që OSSh të inkasonte të hyra nga ofrimi i shërbimeve të parapara në metodologjinë e taksave për kyçje. Sidoqoftë, kurdo që realizimi i këtyre hyrave të parregulluara dhe kostove të përjashtuara mund të jetë i ndryshëm nga vlerësimi i ZRRE-së, ato përshtaten në baza vjetore sikurse deri më tani.

5.5.3 Përshtatjet e rregullta vjetore 2023

5.5.4 Komentet e KEDS

Është vërejtur se ZRRE-ja në përshtatjet për inflacion të shpenzimeve operative, nuk ka marr parasysh total OPEX-in e aprovuar për vitin 2022. OSSh në aplikimin e tij ka kërkuar që t'i njihen kostot e jo balancave për muajt korrik-shtator, të cilat janë shkaktuar si rezultat i pamundësisë së blerjes së energjisë elektrike të nevojshme për mbulimin e humbjeve, për shkak të ngjarjes së jashtëzakonshme dhe pas ndërmarrjes të të gjitha veprimeve për parandalimin e tyre. Marrë parasysh si më lartë, faktori korrigjues i OSSh-së për vitin 2022 është 28.5 milion euro nga 24.94 sa ka propozuar ZRRE-ja në Raportin Konsultativ. ZRRE në raportin konsultativ, ka ndarë faktorin korrigjues (KREV) për 5 vite dhe ka shpërndarë të njëjtët përgjatë periudhës së tretë rregullative në mënyrë të barabartë, duke e trajtuar të njëjtën ngjashëm sikurse korrigjimet që bëhen për periudhë rregullative.

5.5.5 Përgjigjja e ZRRE-së

ZRRE pajtohet me komentin e KEDS për përfshirje të kostove shtesë prej 0.24mil€ (të lejuara në vitin 2020 që kanë të bëjnë me kostot e sigurimit shëndetësor dhe sigurimit të automjeteve), duke qenë se këto kosto janë jashtë kontrollit të të licencuarit. Pas indeksimit për HICP vlere e përshtatjes për OPEX nga 2.20mil€ sa ishte në propozimin fillestar korrigjohet në 2.22mil€.

Kostot që kanë të bëjnë me OPEX-in e pa-kontrollueshëm janë azhurnuar edhe për PRR3 për të reflektuar kostot e sigurimit shëndetësor dhe sigurimit të automjeteve si kosto që janë jashtë kontrollit të të licencuarit

Lidhur me kostot e jo-balanceve, ZRRE e kupton shqetësimin e KEDS, mirëpo siç dihet balancimi i sistemit është përgjegjësi e KOSTT, dhe për këtë qëllim ZRRE ka lejuar kostot e balancimit KOSTT-it. Andaj, në harmoni edhe me shqyrtimet paraprahe, të hyrat dhe kostot e OSSH-së për shërbime të tilla nuk janë trajtuar në përcaktimin e MAR, prandaj ZRRE do të vazhdojë me trajtimin e njëjtë.

Në harmoni me Rregullën e të Hyrave të OSSh, precedentët rregullator, ZRRE ka aplikuar përshtatjet vjetore (përfshirë ngjarjen e jashtëzakonshme) dhe ato të periudhës paraprahe duke përshtatur ndikimin në disa vite. Situata të tilla janë të përshkruara në rregullat e të hyrave si në vijim:

“Rregullatori do të marr parasysh gjithashtu ndikimet e vazhdueshme të ngjarjeve të jashtëzakonshme (që e kalojnë pragun e materialitetit) në shqyrtimet e ardhshme periodike”;

“Koha dhe struktura e përshtatjes së jashtëzakonshme do të shmangë, ku është e mundur, rritjet e menjëhershme të tarifave tek konsumatorët (për shembull duke zbutur ndikimin e përshtatjes së jashtëzakonshme brenda disa viteve)”.

6. Përmbledhje e MAR të OSSH (KEDS)

Pas vlerësimit të të gjitha të dhënave në dispozicion dhe atyre të paraqitura nga palët e përfshira në proces, si dhe pas komenteve të pranuar nga palët gjatë konsultimit publik, duke marrë në konsideratë edhe vendimet e Bordit të ZRRE-së për vlerat hyrëse për PRR3, vlerësimi dhe propozimi përfundimtar i ZRRE-së për të Hyrat e Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) për periudhën e tretë rregulative 2023-2027 është si më poshtë:

€000s	PRR3				
	2023	2024	2025	2026	2027
	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
Baza e Opex-it	28,241	27,848	27,461	27,079	26,704
Kostot e humbjeve	76,721	76,516	69,697	64,001	59,407
Zhvlerësimi	17,303	19,414	21,541	22,306	23,608
Kthimi i Lejuar	14,886	16,338	17,720	18,546	18,974
Kostot e përjashtuara	-408	-408	-408	-408	-408
Të hyrat jo-tarifore	-5,000	-5,000	-5,000	-5,000	-5,000
Obligimet ndaj OS dhe OT	1,884	1,884	1,884	1,884	1,884
Taksa për licence	90	90	90	90	90
HLM fillestar	133,718	136,683	132,985	128,500	125,259
Përshtatjet 2022 dhe PRR2	89	89	89	89	89
Gjithsejtë HLM i propozuar	133,807	136,772	133,075	128,589	125,349

Siç është theksuar në vazhdimësi, komponentët e kostove të të Hyrave të Lejuara Maksimale përshtaten në baza vjetore sipas dispozitave të parapara në rregullat e të hyrave me qëllim të reflektimit të kostove të arsyeshme të shërbimit dhe furnizimit me energji elektrike për vitin përkatës.